



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 5.12.2022

**Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 5.12.2022, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 264, datë 17.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Elona Toro

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë (IKP), më datë 18.9.2020, është njoftuar vendimi nr. 264, datë 17.6.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Elona Toro, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të vendimit nr. 264, datë 17.6.2020, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Toro.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar ankim.

Komisioneri Publik, nëpërmjet këtij mjeti procedural (ankimit), në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, kërkon rishikimin e vendimit nr. 264, datë 17.6.2020, të Komisionit, nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, *personave të lidhur dhe të tjerë të lidhur* me të, administrimit të provave të nevojshme në vlerësimin e aftësisë dhe mjaftueshmërisë së burimeve financiare dhe mënyrën e krijimit të pasurive, si dhe shpenzimeve të deklaruar dhe ato të rezultuara nga hetimi administrativ, me qëllim justifikimin bindshëm të burimit të krijimit të tyre, sipas kërkesave të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Komisioneri Publik, duke iu qëndruar shkaqeve të parashtruara në ankimin e tij, çmon se vendimi nr. 264/2020 është i cenueshëm, për shkaqe të mjaftueshme ligjore duhet t'i nënshtrohet juridiksionit rivlerësues dhe kontrollues nga Kolegji i Posaqëm i Apelimit, e për këto arsye, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i kërkojmë Kolegjit vlerësimin e çështjeve si më poshtë.

## I. Vlerësimi mbi pasuritë e subjektit të rivlerësimit

1. Nga aktet në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të<sup>1</sup> kanë në bashkëpronësi pasuritë: (1) “Apartament me sip.112,7 m<sup>2</sup>”, ndodhur në Rrugën e \*\*\*, Tiranë, me vlerë 135.000 euro; (2) “Vend parkimi (garazh), ndodhur në Rrugën e \*\*\*, Tiranë, me vlerë 12.000 euro; (3) “Apartament me sip.85,7 m<sup>2</sup>”, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë (fituar me kontratë shkëmbimi trualli ); (4) Automjet tip “Benz Mercedes” (fituar me kontratë shkëmbimi); (5) Likuiditete në llogaritë bankare në emër të subjektit dhe *personave të lidhur me të*,<sup>2</sup> në shumën totale prej rreth 5.000.000 lekë.

2. Për pasuritë listuar si më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi hua, dhurime dhe të ardhura nga pagat. Në analizë të elementeve të lidhura me pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, hetimit dhe vlerësimit të kryer nga Komisioni, Komisioneri Publik, në *ankimin e datës 5.10.2020*, ka kërkuar hetim të mëtejshëm për sa u përket pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën “Vetting”, lidhur me çështjet në vijim:

2.1 Verifikimin e mundësisë financiare të *personave të tjerë të lidhur*, për të mbuluar me burime të ligjshme shumat e deklaruara dhënë subjektit të rivlerësimit, në formën e dhurimeve nga z.\*\*\*.\*\*\*, i ati i subjektit, dhe z. \*\*\*.\*\*\*, vjehri i subjektit, dhe huas së marrë nga z. \*\*\*.\*\*\*, duke u përqendruar, ndër të tjera: *i.* në përputhjen e periudhës kohore të të ardhurave dhe shpenzimeve të analizuar; *ii.* numrin e personave të analizuar që rezultojnë sipas përbërjes familjare, si dhe *iii.* përfshirjen në analizë të të gjitha shpenzimeve dhe investimeve të evidentuara gjatë hetimit administrativ.

2.2 Verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme nga të ardhura të ligjshme, pasuritë dhe shpenzimet e deklaruara në Deklaratën “Vetting”, si dhe ato të rezultuara gjatë hetimit administrativ.

3. Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson që, në funksion të shkaqeve të ankimit, Kolegji, brenda juridiksionit të tij kontrollues dhe rivlerësues, të riçelë hetimin administrativ, me qëllim kryerjen e një llogaritjeje të zërave përkatës financiarë të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur me të dhe personave të tjerë të lidhur me të, të deklaruar nga subjekti, si burim për krijimin e secilës pasuri, për elementet trajtuar në vijim.

**4. Pasuria nr.1, “Apartament me sip. 112,7 m<sup>2</sup>”, ndodhur në Rruga e \*\*\*, Tiranë (në vijim referuar si “Apartament me sip. 112,7 m<sup>2</sup>”)**

4.1 Në D-Vett., subjekti deklaron: Apartament banimi me nr. pasurie \*\*\*, Z. K. \*\*\*, me sip. totale 112,7 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën e \*\*\*, Tiranë. Vlera 135.000 euro. *Pjesa takuese: 100% në*

<sup>1</sup> Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z.\*\*\*.\*\*\*, si person i lidhur, ka deklaruar si pasuri veçmas “Apartament me sip. 52.8 m<sup>2</sup>+52.8 m<sup>2</sup>”, ndodhur në rrugën “\*\*\*\* \*\*\*\*”, Tiranë (¼ bashkëpronësi me prindërit dhe motrën e tij).

<sup>2</sup> Bashkëshorti \*\*\*.\*\*\*, vajza \*\*\*.\*\*\*, djali \*\*\*.\*\*\*.

bashkëpronësi me bashkëshortin. *Burimi i krijimit: i)* 5.800.000 lekë, përfituar nga kontrata nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*.9.2006, e shitjes së apartamentit në rrugën “\*\*\*\* \*\*\*\*”, pall.\*\* , ap.\*\* , Tiranë; *ii)* 45.000 euro, sipas kontratës së huas nr.\*\*\* rep. nr.\*\*\* kol., datë \*\*.7.2008; *iii)* Kredi e marrë nga “\*\*\*\* \*\*\*\*” (në vijim referuar si \*\*\*), në shumën 5.000.000 lekë, sipas kontratës kredi bankare nr.\*\*\* rep. nr.\*\*\* kol., datë \*\*.2.2011; *iv)* 1.980.000 lekë përfituar nga ekzekutimi i Vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë nr.\*\*\* datë \*\*.3.2006.

4.2 Në DV-2009, në faqen nr. 3, ku kërkohet të deklarohen ndryshimet e interesave privatë, subjekti deklaron: - Nga ekzekutimi në datën \*\*.7.2009, i Vendimit nr.\*\*\*, datë \*\*.3.2006, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, bashkëshorti z.\*\*\*.\*\*\* ka përfituar dëmshpërbllim në shumën 2.000.000 lekë; - Me kontratë sipërmarrje datë \*\*.7.2009, bashkëshorti ka porositur një apartament te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me sipërfaqe 130 m<sup>2</sup>, në rrugën e \*\*\*, Tiranë, me vlerë 135.000 euro, nga të cilat i ka mbetur si detyrim i pashlyer 80.000 euro<sup>3</sup>. - Me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.9.2009 subjekti dhe i ati i saj kanë shitur apartamentin në rr. “\*\*\*\* \*\*\*\*”, në shumën 5.800.000 lekë. Në po të njëjtin formular, në rubrikën “*Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, subjekti deklaron: Kontratë huaje nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.7.2008,<sup>4</sup> me të cilën bashkëshorti \*\*\*.\*\*\* i ka marrë hua z. \*\*\*.\*\*\*, shumën 45.000 euro. – I kam marrë babait shumën që ka pasur në \*\*\* Bank, 6.000 euro dhe 4.000 USD.

4.3 Në DV 2010, subjekti nuk deklaron rrethana të reja faktike lidhur me këtë pasuri, përveç shlyerjes së shumës 5.000 euro, si detyrim ndaj një personi fizik.

4.4 Në DV-2011, subjekti, ndër të tjera, deklaron përmbushjen e detyrimeve ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., nëpërmjet kredisë marrë nga \*\*\*, në shumën 5.000.000 lekë, me afat deri në datën \*\*.3.2031.

4.5 Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga kontrata e sipërmarrjes, datë \*\*.7.2009, dhe kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*.9.2012. Në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar dhe mënyrat e shlyerjes së kësaj pasurie<sup>5</sup>.

4.6 *Lidhur me burimin, 6.000 euro dhe 4.000 USD, të tërhequra nga llogaria e babait të subjektit, konstatohet se ky burim nuk është deklaruar nga subjekti në D. Vett., por në DV-2009.*

4.6.1 Referuar nenit 3, pika 14, dhe nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni e ka kualifikuar babain e subjektit “*person tjetër të lidhur*”, me subjektin e rivlerësimit, që mbart detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre depozitave bankare dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës për ligjshmërinë e burimeve të z.\*\*\*, për krijimin e depozitave bankare, të cilat rezultojnë të krijuara në periudhën shtator 2007 - nëntor 2008, pasi nga analiza

<sup>3</sup> Bazuar në aktet në dosje, pagesat për apartamentet janë kryer në vitet 2008, 2009 dhe 2010, dhe deklarimi i subjektit në DV- 2009, se ka mbetur për t’u shlyer 80.000 euro, nuk është i saktë dhe nuk përputhet me aktet në dosje.

<sup>4</sup> Gjatë hetimit administrativ, subjekti deklaron se kontrata është nënshkruar në \*\*.7.2009, por është një lapsus i noterit, duke sjellë edhe kopje të Regjistrisë noterial të vitit 2009.

<sup>5</sup> (1) Kësti i parë, në shumën 12.000 euro, është paguar në datën \*\*.7.2009 me burim: i) 6.000 euro dhe 4.000 USD, të tërhequra nga llogaria e babait; ii) 3.200 euro nga kësti i parë, në shumën 10.000 euro, nga huaja e marrë *cash* nga \*\*\*.\*\*\*, fakt ky i padeklaruar në deklaratën periodike të kohës. (2) Kësti i dytë, në shumën 40.000 euro, është paguar në datën \*\*.11.2009, me burim: i) 39.200 euro, përfituar me kontratën e shitblerjes nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*.9.2009, në bashkëpronësi të subjektit dhe babait të saj, z. \*\*\*.\*\*\*; ii) 790 euro nga të ardhurat tona. (3) Kësti i tretë, në shumën 50.000 euro, është paguar në datën \*\*.3.2010, me burim: i) 32.500 euro, pjesë e kështit të dytë të kontratës së huas; ii) 2.500 të dhëna *cash* nga z. \*\*\*.\*\*\*, si pjesa e dytë e kështit të dytë të kontratës së huas; iii) 1.947.089 lekë, nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor; iv) 150.661 lekë nga mbylljet e llogarive tona. (4) Kësti i katërt dhe i fundit, në shumën 33.000 euro, është paguar në datën \*\*.5.2011, me shumën 5.000.000 lekë, nga kredia e marrë në \*\*\*.

financiare për *personin tjetër të lidhur*, z. \*\*\*, për periudhën deri në korrik 2009, është konstatuar pamjaftueshmëri për mbulimin me burime të ligjshme të kursimeve dhe shpenzimeve deri në këtë periudhë në shumën – 804.829 lekë.

4.6.2 Pas shpjegimeve përfundimtare të subjektit, datë 6.6.2020, dhe provave të depozituara, Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] *Referuar analizës së kryer dhe vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe fakteve të pasqyruara si më sipër, bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, si dhe në mungesë të indiceve të besueshme për fshehje pasurie të subjektit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se personi tjetër i lidhur (babai i subjektit të rivlerësimit) ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e shumave 6.000 euro dhe 4.000 USD, të dhëna në favor të subjektit, me qëllim kryerjen e pagesës së këstit të parë për blerjen e apartamentit objekt hetimi [...].<sup>6</sup>*

4.7 *Lidhur me burimin hua, në shumën 45.000 euro, marrë nga z. \*\*\*,\*\*\**

4.7.1 Në dosje të hetimit administrativ rezulton e depozituar kontrata e huas nr.\*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.7.2008, nënshkruar ndërmjet shtetasve \*\*\*,\*\*\*, në cilësinë e huadhënësit dhe z. \*\*\*,\*\*\*, në cilësinë e huamarrësit, për marrjen nga ky i fundit hua të shumës 45.000 euro, dhënë me 3% interes vjetor.

4.7.2 Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo shumë është marrë me disa këste, respektivisht: (i) 10.000 euro, marrë në vitin 2009 (nga të cilat është përdorur për pagesën e këstit të parë të apartamentit vetëm shuma prej 3.200 euro, pjesa tjetër mbetur në banesë<sup>7</sup>); (ii) shuma 4.500.000 lekë, transferuar nga shtetasi \*\*\*,\*\*\*, nëpërmjet llogarisë bankare në datë \*\*.3.2010; (iii) shuma 2.500 euro, dhënë *cash* në vitin 2010 bashkëshortit, për të plotësuar shumën prej 45.000 euro të dakordësuar.

4.7.3 Komisioni, referuar nenit 3, pika 14, dhe nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, ka konsideruar shtetasin \*\*\*,\*\*\* si *person tjetër të lidhur* dhe i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të dokumentojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të këtij shtetasi.

4.7.4 Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar se: [...] *shtetasi \*\*\*,\*\*\* ka ushtruar prej vitesh aktivitet, dhe burimi i të ardhurave të dhëna hua rrjedh nga të ardhurat nga aktiviteti i z.\*\*\*,\*\*\*, nga të ardhurat nga shitja e pasurive në pronësi të babait z. \*\*\*,\*\*\*, të ardhura të cilat janë administruar nga huadhënësi z.\*\*\*,\*\*\*, të ardhura nga pjesëmarrjet në aksionet e disa shoqërive aksionere, të ardhura nga interesat bankare etj.[...], duke depozituar dokumentacion justifikues,<sup>8</sup> e theksuar faktin se huadhënësi, shtetasi \*\*\*,\*\*\*, për periudhën deri në momentin e dhënies së huas, nuk rezulton të ketë investuar në pasuri të paluajtshme apo të luajtshme (automjete).*

4.7.5 Për sa më sipër, Komisioni, pasi ka vlerësuar bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, pas administrimit të dokumentacionit nga ky i fundit, ka kryer analizën financiare të *personit tjetër të*

<sup>6</sup> Shihni f. 30, të vendimit të Komisionit.

<sup>7</sup> Në DV-2009, subjekti nuk ka deklaruar posedim të likuiditeteve në *cash*.

<sup>8</sup> Deklaratë notoriale nr. \*\*\*/\*\*\* datë \*\*.10.2019, kontrata shitje pasuri të paluajtshme, ku njëri nga shitësit rezulton \*\*\*,\*\*\* me pjesë takuese ½ e 1/3 për vitet 1998-2006; kontratë shitje e apartamentit në Shkodër në bashkëpronësi të huadhënësit \*\*\*,\*\*\* dhe dy prindërve të tij \*\*\*,\*\*\* dhe \*\*\*,\*\*\*, dokumente nga organet tatimore mbi të ardhurat/xhirot për periudhën 1994-2008; të dhëna nga QKB mbi pjesëmarrjet në shoqëritë aksionare të \*\*\*,\*\*\* dhe \*\*\*,\*\*\*; dokumente nga ISSH, mbi masën e pensionit të prindërve \*\*\*,\*\*\* dhe \*\*\*,\*\*\*, dokumente nga institucionet mbi të ardhurat e përfutuara të shtetasit \*\*\*,\*\*\*, nga statusi i veteranit.

*lidhur \*\*\*.\*\*\*, për periudhën 1994-2009 dhe, bazuar në parimin e propocionalitetit, ka arsyetuar se [...] personi tjetër i lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*, ka pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar plotësisht dhënien e huas në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit [...]’<sup>9</sup>.*

4.8 *Lidhur me burimin 39.200 euro, e ardhur nga shitja e pasurisë në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të atit të saj. z. \*\*\*.\*\*\**

4.8.1 Në DV-2009, subjekti deklaroi se me kontratën e shitjes nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*.9.2009, subjekti dhe i ati i saj kanë shitur apartamentin në rr. “\*\*\*.\*\*\*”, në shumën 5.800.000 lekë.

4.8.2 Nga hetimi ka rezultuar se kjo pasuri dhe pjesa e saj takuese nuk ka qenë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI. Subjekti ka deklaruar se: [...] *Në DV-2009 kam shënuar se shuma prej 5.800.000 lekësh është përfituar nga shitja e apartamentit, në bashkëpronësi me babanë dhe, meqenëse gjysmën ligjore të kësaj shume babai ma dha pa ndonjë kontratë dhurimi apo aktmarrëveshje, nuk e kam shënuar si dhurim [...].*

4.8.3 Komisioni, për verifikimin e përmbushjes eventuale të kriterëve ligjore, të parashikuara në nenin D të aneksit të Kushtetutës, të burimit që ka origjinë këtë marrëdhënie ligjore, ka pranuar të mjaftueshëm pohimin e subjektit gjatë seancës dëgjimore të datës 12.6.2020.

4.8.4 Në përfundim, Komisioni edhe pse arsyeton se: [...] *Fakti i përfitimit nga subjekti të shumës së plotë nga shitja e pasurisë në bashkëpronësi me babanë, merr kuptim dhe duhet të jetë pjesë e verifikimeve që kryhen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në zbatim të detyrimit kushtetues që ka subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës për të provuar burimin e ligjshëm të pasurive [...], ka konkluduar se: [...] pasaktësitë në deklaram janë pa pasoja dhe, si të tilla, nuk janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar. Për sa më sipër, në vlerësimin tërësor dhe në harmoni të provave shkresore të administruara në dosje, transaksioneve të kryera, deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, ndër vite, në ILDKPKI dhe shpjegimeve të dhëna nëpërmjet pyetësorëve/prapësimeve të dërguara në kuadër të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, trupi gjykues krijoi bindjen se të ardhurat (minus tatimin e paguar) nga shitja e apartamentit në vitin 2009, në bashkëpronësi me babanë, janë përfituar plotësisht nga subjekti i rivlerësimit dhe kanë shërbyer si burim krijimi i pasurisë objekt hetimi [...]’<sup>10</sup>.*

**5. Pasuria nr. 2, “Vend parkimi (garazh), ndodhur në rrugën e \*\*\*, Tiranë (në vijim referuar si “garazhi”)**

5.1 Në D-Vett., subjekti deklaroi: *Vend parkimi (garazh), ndodhur në rrugën e \*\*\*, Tiranë. Vlera: 12.000 euro. Burimi i krijimit: i) 10.000 euro kontribut nga babai i bashkëshortit tim, pa dokument, për shkak të lidhjes së posaçme; ii) 2.000 euro, e shlyer nga ne. Pjesa takuese: 100% në bashkëpronësi me bashkëshortin, z. \*\*\*.\*\*\*.*

5.2 Në DV-2011, subjekti deklaroi: *Blerje vend parkimi në shumën 12.000 euro. Burimi: 10.000 euro janë dhënë nga babai i bashkëshortit (vjehtëri) në dy pjesë, pa dokument. 2.000 euro,<sup>11</sup> detyrim i mbetur ndaj shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., në lidhje me vendparkimin.*

<sup>9</sup> Shihni f.19, të vendimit të Komisionit.

<sup>10</sup> Shihni f. 9, të vendimit të Komisionit.

<sup>11</sup> Në DV-2012, subjekti ka deklaruar shlyerjen e shumës 1900 euro.

5.3 Komisioni, referuar nenit 3, pika 14, dhe nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, i ka cilësuar prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit si *persona të tjerë të lidhur*, duke u kërkuar shpjegime lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të tyre.

5.4 Subjekti i rivlerësimit, pasi ka paraqitur dokumentacionin përkatës, ka parashtruar se: [...] në vitin 1992, nga Bashkia Tiranë, familjes Toro iu kthye një nga vilat më me vlerë në Tiranë (bashkëpronar i së cilës ishte edhe babai i bashkëshortit të subjektit). Që nga ky vit e në vijim, deri në shitjen e saj, familja Toro ka pasur marrëdhënie qiraje në vlerën rreth 5.000 USD/muaj... Në datën \*\*.12.2001, familja Toro shiti pasurinë vilë +truall, të ndodhur në Rr. "\*\*\*\* \*\*", në vlerën 500.000 USD, për të cilën është paguar edhe tatimi mbi kalimin e pronësisë, në vlerën rreth 15,000 USD. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se, në datën \*\*.3.2009, ka ndërruar jetë halla e bashkëshortit, znj. \*\*\*.\*\*\*, e cila ka qenë beqare dhe pa fëmijë. Si trashëgimtar ligjor ishte edhe i ndjери, z. \*\*\*.\*\*\*, në ¼ pjesë të pasurisë së saj. Sikundër pasuria e krijuar nga prona e sipërcituar, e dhënë me qira e më pas e shitur, dhe halla e bashkëshortit të subjektit gëzonte pjesën e saj në këtë pasuri. Këto të ardhura dhe kursimet e saj ndër vite i krijuan babait të bashkëshortit të subjektit edhe një kreditim tjetër të pasurisë së tij. Burim tjetër i të ardhurave të babait të bashkëshortit të subjektit janë pensionet e pleqërisë, bonot e thesarit, dëmshpërblimi si i përndjekur politik [...], duke bashkangjitur dhe kopje të dokumenteve për të provuar sa më sipër deklaruar.

5.5 Në vendimin e tij, konstatohet se Komisioni arsyeton: [...] Meqenëse Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë dhe të provojë me dokumentacion justifikues ligjor burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për çdo shumë të dhuruar nga z. \*\*\*.\*\*\*, analiza financiare dhe verifikimi i ligjshmërisë së burimit të krijimit për të ardhurat e tij është kryer njëherësh për totalin e shumave të dhuruara [...]<sup>12</sup>. Në këtë gjendje të akteve rezulton se Komisioni në vendimin e tij konkludon se: [...] është fakt se, referuar të dhënave nga \*\*\*-ja, rezulton se në llogarinë e përbashkët, në dollarë, të shtetasve \*\*\*, dhe \*\*\*.\*\*\* (prindërit e bashkëshortit të subjektit), në datën \*\*.9.2002, kanë qenë të depozituara në depozitë me afat shumë 41.000,48 USD dhe 80.429 USD. Gjithashtu konstatohet se z. \*\*\*.\*\*\*, babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ka përfutur pension pleqërie, që nga korriku i vitit 1990, në masën aktuale 26.895 lekë/muaj. Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, vetëdeklarimeve të subjektit dhe provave të depozituara në Komision në kuadër hetimit administrativ, trupi gjykues vlerëson se z. \*\*\*.\*\*\* ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar shumat e dhuruara ndër vite, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të [...]<sup>13</sup>.

## **6. Dhurimet e personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\***

6.1. Në deklaratat periodike vjetore, dorëzuar pranë ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka përfutur dhurime për fëmijët e saj, nga babai z. \*\*\*.\*\*\*, për periudhën 2008-2016, shumën totale prej 950.000 lekë.

6.2. Komisioni, sikundër detajuar më lart, ka cilësuar z. \*\*\*.\*\*\* si *person tjetër të lidhur* dhe ka kryer analizën financiare për të provuar mundësinë e tij për kryerjen e dhurimeve në favor të

<sup>12</sup> Shihni f. 36, të vendimit të Komisionit.

<sup>13</sup> Shihni f. 39, të vendimit të Komisionit.

subjektit të rivlerësimit (kreditimi i llogarive bashkëmërore me fëmijët e saj), për periudhën \*\*8.2009 – \*\*12.2016, në vlerë totale për këtë periudhë prej 800.000 lekësh<sup>14</sup>.

6.3. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar<sup>15</sup>se: [...] *Referuar analizës financiare konstatohet se personi tjetër i lidhur ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht shumat e dhuruara për subjektin e rivlerësimit/nipërit e tij, të deklaruara ndër vite [...].*

### **7. Në lidhje me analizën financiare të mbulimit me burime të ligjshme të shpenzimeve dhe kursimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të<sup>16</sup>, për periudhën 2003 – 2016**

7.1. Bazuar në aktet në dosje, Komisioni ka kryer edhe analizën financiare në lidhje me verifikimin e mbulimit me burime të ligjshme të shpenzimeve dhe kursimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të, për periudhën 2003 – 2016, nga e cila ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, shpenzimet dhe investimet për vitet 2012 dhe 2015, për një diferencë negative prej - 370.165 lekë. Lidhur me këtë konstatim, i ka kaluar subjektit barrën e provës për diferencën e vitit 2012, si dhe i ka kërkuar shpjegime për diferencën e konstatuar në vitin 2015.

7.2. Pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit, trajtuar gjerësisht në ankim, në përfundim Komisioni ka vlerësuar se: [...] *Shpjegimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ, të pabazuara në prova...Pasaktësitë në deklarim dhe balanca negative e fondeve nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se, në asnjë rast, pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit<sup>17</sup> [...].*

## **II. Analiza e shkaqeve të ankimit**

**8. Për pasurinë nr.1, Apartament me sip.112,7 m<sup>2</sup>, Tiranë,** Komisioneri Publik, sikundër trajtuar në ankim, i kërkon Kolegjit të rikryejë llogaritjen e zërave përkatës financiarë mbi vlerësimin e mundësisë së *personave të tjerë të lidhur* me subjektin e rivlerësimit, për të mbuluar me të ardhura nga burime të ligjshme huat dhe dhurimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, konkretisht:

8.1 *Lidhur me burimin e huas në shumën 45.000 euro, marrë nga z. \*\*\*,\*\*\**

8.1.1 Referuar gjendjes së akteve, kërkohet rivlerësimi nga Kolegji i mundësisë së *personit tjetër të lidhur* z. \*\*\*, për krijimin me burime të ligjshme të shumës së deklaruar hua, prej 45.000 euro.

8.1.2 Bazuar në provat shkresore të administruara në dosje, rezulton se sipas certifikatës familjare, lëshuar në datën 18.9.2019, në përbërjen familjare të z. \*\*\* rezultojnë 4 persona deri në vitin 1996, 5 persona për periudhën 1996-2006 dhe 6 persona 2006-2009. Kryefamiljar rezulton shtetasi \*\*\*,\*\*\* deri në datën 5.8.2011. Nga verifikimi i zërave përbërës të analizës financiare të personit tjetër të

<sup>14</sup> Komisioni në analizën financiare të kryer ka trajtuar dhurimin e shumës 150.000 lekë në vitin 2008, së bashku me mundësinë e personit tjetër të lidhur për të krijuar depozitat bankare, përdorur si burim krijimi të pasurisë nr.1, sikundër trajtuar më sipër.

<sup>15</sup> Shihni f. 31, të vendimit të Komisionit.

<sup>16</sup> Bashkëshorti dhe fëmijët e subjektit të rivlerësimit.

<sup>17</sup> Shihni f. 50, të vendimit të Komisionit.

lidhur, z. \*\*\*, sikundër detajuar dhe në ankim, rezulton se në zërin të ardhura janë përfshirë si të ardhurat e deklaruara të realizuara nga shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\* që nga viti 1994, ndërkohë që janë llogaritur shpenzime jetese për periudhën **2000-2009**, vetëm për 1 person, sipas standardit të përcaktuar nga INSTAT.

8.1.3 Parë në këtë këndvështrim, mbështetur edhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe në arsyetimin e vetë Komisionit, në vlerësimin e Komisionerit Publik, ai, Komisioni, duhej të kishte hetuar sipas kësaj situatë faktike, mbi të gjitha zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, gjatë periudhës deri në vitin 2009<sup>18</sup>.

Në këtë rast, metodologjia e ndjekur nga Komisioni në vlerësimin e burimeve të ligjshme të krijimit të të ardhurave të ligjshme të personit tjetër të lidhur, është e paqartë dhe nuk mbështetet në jurisprudencën e Kolegjit, duke u konstatuar mangësi në lidhje me përcaktimin e: (i) numrit të personave që sigurojnë burimin e të ardhurave të ligjshme; (ii) periudhën e llogaritjes së krijimit të këtyre të ardhurave; (iii) mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës sipas standardit të INSTAT-it. (ndërkohë që në zërin “të ardhura” përfshihen si të ardhurat e përfituara nga z. \*\*\*.\*\*\* dhe ato të përfituara nga z. \*\*\*.\*\*\*).

8.1.4 Mospërputhja e këtyre elementeve të situatës faktike me atë të përfshirë në metodologjinë e kryerjes së analizës financiare nuk bën të mundur verifikimin të mundësisë financiare të personave të tjerë të lidhur, për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e deklaruar dhënë hua.

8.1.5 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, analiza financiare e personit tjetër të lidhur do të duhej të ishte kryer duke marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e dokumentuara sipas akteve të administruara, për të gjithë periudhën në fjalë.

8.2 Lidhur me burimin e dhurimit në shumën 6.000 euro dhe 4.000 USD nga z. \*\*\*.\*\*\*

8.2.1 Referuar gjendjes së akteve, kërkohet rivlerësim nga ana e Kolegjit i mundësisë financiare të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*, për krijimin me burime të ligjshme të shumave të dhuruara 6.000 euro dhe 4.000 USD.

8.2.2 Nga vlerësimi i zërave të analizës financiare duket se Komisioni, në analizën e pasqyruar në vendimin e arsyetuar, ka përfshirë të ardhurat familjare të dokumentuara dhe që plotësojnë kushtin e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, për periudhën 1991- korrik 2009, ndërkohë në shpenzimet e jetesës ka llogaritur shpenzimet për 1 person sipas standardit të INSTAT, për periudhën 2001-31.7.2009.

8.2.3 Paqartësitë e kësaj metodologjie të ndjekur në rastin në fjalë për kryerjen e analizës financiare dhe rezultatet e arritura për shkak të saj, si për sa i takon: (i) periudhës në të cilën shtrihet kjo analizë; (ii) burimeve të të ardhurave të përfshira; (iii) investimeve të kryera dhe (iv) mundësisë së kursimit, nuk kanë bërë të mundur argumentimin e situatave juridike të vërtetuara, të cilat kanë nevojë të verifikohen dhe mbi to të arrihen përfundime, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 84/2016.

8.2.4 Analiza financiare e personit tjetër të lidhur, për mbulimin me burime të ligjshme të shumave të dhuruara, do të duhej të ishte kryer për periudhën shkurt 2005 – nëntor 2008 (sipas datave të depozitimit të kursimeve në llogaritë bankare), duke i kaluar subjektit të rivlerësimit eventualisht

<sup>18</sup> Referohuni vendimit (JR) nr. 38/2021, prg. 25.12 dhe vendimit (JR) nr. 28/2022, prg. 37.



barrën e provës në lidhje me burimet e ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e dy depozitave, e që janë deklaruar si një ndër burimet për pagesën e pasurisë nr.1, pasi duket se të ardhurat e tij përpara vitit 2005 janë shpenzuar të gjitha për blerjen e pasurisë *apartament*<sup>19</sup> (konkluzion ky lidhur me nevojën e huamarrjes së z.\*\*\* nga subjekti i rivlerësimit dhe nga z.\*\*\*.\*\*\*, sikundër ka rezultuar gjatë hetimit administrativ).

8.3 *Lidhur me burimin e shumës 39.200 euro,*<sup>20</sup>*e ardhur nga shitja e pasurisë në bashkëpronësi e subjektit të rivlerësimit dhe të atit të saj, z. \*\*\*.\*\*\**

8.3.1 Komisioneri Publik, për këtë pjesë të shkakut ankimor, nënvizon evoluimin e jurisprudencës së Kolegjit lidhur me për sa është kërkuar në paragrafin 22 e në vijim të ankimit të datës 5.10.2020, për verifikimin e ligjshmërisë së shumës së dhuruar sipas kërkesave të nenit D të aneksit të Kushtetutës, duke theksuar se mbetet detyrim vlerësimi rast pas rasti i kësaj shtate, duke përfshirë në këtë vlerësim elemente të tilla si deklarimi i saktë, ekzistenca e burimit të ligjshëm, si dhe çdo rrethanë tjetër që shërben në verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurisë.

**9. Për pasurinë nr. 2, *Vend parkimi (garazh)*, nga aktet në dosjen e Komisionit nuk rezulton e dokumentuar analiza financiare për *personin tjetër të lidhur, z.\*\*\**, mungesë e cila ka pamundësuar verifikimin dhe, për pasojë, edhe mundësinë e subjektit që të japë shpjegimet përkatëse për situata faktike, që duket se gjenden të provuara nga aktet e administruara në fashikullin përkatës të Komisionit.**

9.1. Në vijim për pasurinë nr. 2, Komisioneri Publik vlerëson se lidhur me burimin e deklaruar të kontributit prej 10.000 euro nga personi tjetër i lidhur, Kolegji, duhet të riçelë hetimin dhe verifikojë mundësinë financiare të tij, për të dhuruar shumën 10.000 euro të deklaruar, duke konsideruar në vlerësim të kësaj analize mundësinë e tij për të dhuruar edhe shumat e tjera të deklaruara ndër vite, që arrijnë në total në vlerën 3.300.000 lekë.

9.2. Në kryerjen e kësaj analize financiare për *personin tjetër të lidhur, z. \*\*\**, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>21</sup>, duhet të gjejnë trajtim ligjor dhe financiar elemente të tilla që evidentohen nga aktet e administruara nga Komisioni, por që nuk janë hetuar prej tij, të tillë si: (i) periudha e depozitimit dhe debitimet e kryera në llogaritë bankare nga *personi tjetër i lidhur* gjatë periudhës janar 2003 - gusht 2007<sup>22</sup> apo (ii) investimet eventuale të kryera nga *personi tjetër i lidhur*, gjatë periudhës në të cilën janë realizuar dhurimet për familjen e subjektit të rivlerësimit<sup>23</sup>.

9.3. Në përfundim, për këtë pasuri (si dhe për gjitha marrëdhëniet e tjera monetare me *personin tjetër të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\**), Komisioneri Publik thekson nevojën e kryerjes së analizës financiare nga ana e

<sup>19</sup> Rezultojnë se në periudhën tetor 2004 – janar 2005 ka kryer investime në pasuri të paluajtshme: apartament banimi, me sipërfaqe 78 m<sup>2</sup>, me vlerë 51.000 euro, ndodhur në rrugën “\*\*\*\* \*\*\*\*”, Tiranë, transaksion i finalizuar me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\* 4.2013, në vlerën 51.000 euro (paguar deri në janar 2005 shuma 46.000 euro), për blerjen e të cilit ka marrë hua si nga e bija, subjekti i rivlerësimit (sipas deklarimit të saj në DV-2005) dhe nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, sipas deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ.

<sup>20</sup> Shuma nga shitja e apartamentit sipas kontratës nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\* 9.2009 ishte 5.800.000 lekë, nga të cilat 5.418.944 lekë është vlera e mbetur pas pagesës së tatimit mbi të ardhurat, e cila e konvertuar në euro është 39.210 euro.

<sup>21</sup> Referohuni vendimit (JR) 18/2022, pgr. 36.2.

<sup>22</sup> Nga analizimi i lëvizjeve të llogarive bankare dhe bonove të thesarit, rezultojnë se shumat e depozituar (deklaruar nga subjekti se si burim krijimi ka të ardhurat nga pasuria në adresën Rruga “\*\*\*\* \*\*\*\*”) janë tërhequr plotësisht me disa debitime të pjesshme (përveç shumës prej 310.000 lekë gjendje në Bono Thesari), së bashku me interesat e përfituara, në periudhën janar 2003 - gusht 2007.

<sup>23</sup> Referuar shkresës nr.\*\*\* prot., datë \*\* 10.2019, e OSHEE, me gjeneralitetin \*\*\*.\*\*\* identifikohet një abonent me kontratë furnizimi në instancën Kavajë dhe me gjeneralitete \*\*\*.\*\*\* identifikohet një abonent në instancën Tiranë, si dhe shkresa nr. K-\*\*\* prot., datë \*\* 9.2019, UK Tirana sh.a., për një abonent me gjeneralitete \*\*\*.\*\*\*.

Kolegjit për të evidentuar mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*, për të mbuluar me burime të ligjshme, shumat e dhuruara familjes së subjektit të rivlerësimit<sup>24</sup>.

**10. Për sa i përket dhurimeve të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*,\*\*\*,** rezulton se Komisioni, në kryerjen e analizës financiare për të vlerësuar mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*, për të dhuruar shumën 800.000 lekë, për periudhën 2009 - 2016, ka marrë në konsideratë në shpenzimet e tij, shpenzimet e jetesës për këtë periudhë dhe shpenzimin për pagesën e këstit të fundit pasurisë së tij, apartament, blerë në vitin 2013.

10.1. Komisioneri Publik vlerëson se në analizën financiare të kryer për mundësitë e *personit tjetër të lidhur, z. \*\*\**, për të dhuruar shumat e deklaruara, duket se duhet të përfshihen dhe të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ mbi investimet e këtij të fundit në pasuri të luajtshme, depozita bankare të krijuara nga ana e tij në periudhën 2014 - 2016<sup>25</sup>, pasi vlerësohet se të ardhurat e ligjshme të realizuara për vitet e analizuara janë të pamjaftueshme për të mbuluar njëkohësisht shpenzimet e evidentuara, krijimin e depozitave bankare dhe dhurimet e deklaruara.

**11. Për sa i përket analizës financiare të periudhës së deklaramit 2003-2016 për subjektin dhe personat e lidhur me të**

11.1. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, analiza financiare e kryer nga ana e Komisionit nuk është e plotë dhe nuk është hetuar për të gjitha elementet e saj<sup>26</sup>, pasi përveç sa konstatuar për vitet 2012 dhe 2015, nga vlerësimi i të dhënave rezulton se në gjendjen që janë aktet, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet edhe për vitet 2014 dhe 2016.

11.2. Nisur nga kjo gjendje që janë aktet e dosjes përkatëse, Komisioneri Publik konstaton të nevojshme kryerjen e një hetimi të plotë nga ana e Kolegjit me qëllim: (i) vlerësimin e mundësisë financiare për personat e cilësuar si "*persona të tjerë të lidhur*" me subjektin e rivlerësimit (\*\*\*,\*\*\*, \*\*\*,\*\*\* dhe \*\*\*,\*\*\*), për sa trajtuar gjerësisht më sipër; (ii) dhe në varësi të rezultateve, kryerjen e analizës financiare për subjektin e rivlerësimit për periudhën e deklaramit, duke rivlerësuar zërat përbërës të saj për çdo vit. Vlerësimi i këtyre rrethanave merr rëndësi në rastin konkret, pasi, eventualisht, ato do të ndikonin në vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive dhe shpenzimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

---

<sup>24</sup> Përveç shumës 10.000 euro, deklaruar dhuruar për blerjen e pasurisë *garazh*, rezulton se prindërit \*\*\*,\*\*\* i kanë dhënë subjektit dhe personit të lidhur me të shumën prej 8.000 euro, për pasurinë apartament në Vlorë, në vitin 2014, dhurata në *cash* fëmijëve për periudhën 2010-2016, si dhe ka investuar në blerjen e një automjeti në shumën 11.000 euro, në vitin 2013, në blerjen e një apartamenti në \*\*\*, Durrës, deklaruar se përdoret nga fëmijët e subjektit të rivlerësimit.

<sup>25</sup> Depozita të llogaritura në një vlerë prej 1.390.198 lekë.

<sup>26</sup> Në analizën e vënë në dispozicion duket se shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur vetëm për periudhën 2014-2016 dhe jo në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga Kolegji në vendimin (JR) 11/2019, si dhe të ardhurat e personit të lidhur, \*\*\*,\*\*\*, për vitet 2012-2016, duket se nuk mbështeten në aktet në dosje dhe nuk janë në përputhje me vendimin (JR) 27/2019, zëra të cilët, përveçse do të thellonin diferencën e konstatuar nga Komisioni për vitet 2012 dhe 2015, do të çonin në pamjaftueshmëri financiare dhe për vitet 2014 dhe 2016.

### **III. Konkluzione**

**12.** Mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, kërkohet që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke disponuar çeljen e hetimit dhe marrjen e provave përkatëse, sipas kërkimeve të ankimit dhe kësaj parashtrëse.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**